

ABSTRAKT

TEMA: *“Natyra e çështjeve pronësore në Praktikën Gjyqësore të Gjykatave Themelore në Republikën e Kosovës: shkaqet, baza ligjore dhe trajtimi i tyre”*

Kandidat : *Eliron Olluri*

Mentor: Prof. Asoc. Dr. Qerkin Berisha

E drejta e pronësisë është e drejtë sendore, e cila titullarit të vet i jep autorizime më të plota për cdo pushtet juridik privat, cka rendi juridik e lejon ndërsa shteti në anën tjetër e garanton. Pronësia midis të drejtave reale është e drejta e cila përfshinë më shumë tagra të cilat janë potencialisht të pakufizuara. Pamvarsisht formulimeve që mund të hasim lidhur me të drejtën e pronësisë, në përmbajtje hasim detyrimisht tri autorizime që kanë të bëjnë me përdorimin, shfrytëzimin dhe disponimin e një sendi.

Si objekt studimi i këtij punimi shkencore është hedhja dritë në pyetjen se cila është natyra juridike e çështjeve pronësore në gjykata, dhe cilët janë ata faktorë që kanë ndikuar që të kemi një natyrë të tillë të çështjeve pronësore në gjykatat e shkallës së parë

Nga hulumtimi dhe studimi i një numëri jashtëzakonisht të madh të çështjeve pronësore në gjykata si çështje më të përhapura në gjykatat themelore të Republikës së Kosovës janë:

1.Kërkesat për vërtëtimin e të drejtës së pronësisë, **2.**Kërkesat për mbrojtjen e pronësisë dhe **3.**Pengim Posedimi.

Sendet e paluajtshme kanë një rëndësi të veçantë në qarkullimin juridiko-civil dhe si të tillë gëzojnë një regjim të veçantë ligjor, ky kuadër i veçant ligjor rrjedh nga fakti se sendet e paluajtshme dhe të drejtat e tjera reale që lidhen me to duhet të regjistrohen në regjistrat e pasurive të paluajtshme, mirëpo ky fakt për arsye të ndryshme dhe rrethanave të kohës nuk është respektuar dhe përmbushur në të kaluarën ku shumica e transaksioneve të cilat është dashur të kryhen përmes kontratave formale janë realizuar përmes marrëveshjeve gojore me c’rast i ka hapë rrugë edhe keqpërdorimeve të shumta duke ndikuar kështu në rritjen e kontesteve në gjykata. Si shkaqet kryesore që kanë ndikuar në paraqitjen e këtyre kontesteve pronësore në gjykata janë: 1) lidhja e kontratave jo-formale 2) kërkesa për anulimin e punëve juridike si bazë e fitimit të drejtës së pronësisë, 3) mos regjistrimi i pronësisë në regjistrin për Regjistrimi të drejtave në paluajtshmëri, 4) transaksionet jo-formale të bartjes së trashëgëmisë, 5) uzurpimet, 6) ndërtimi përtëj vijës së kufirit, 7) shitëblerjet e pronave me dokumente të falsifikuara etj.

Në kapitullin e fundit është e trajtuar çështja e pengim posedimit. Tema trajton në menyrë të përgjithshme çështjen e pengim posedimit si dhe rregullimit të tij me ligjet e Republikës së Kosovës, nga mënyrat e fitimit, mbrojtja e posedimit me anë të padisë: padia për pengim posedim dhe kthimit të sendit në posedim. Sikurse edhe kapitujt të lartë përmendur edhe kapitulli

ku është e trajtuar pengim posedimi do të jenë të përfshira shkaqet kryesore e paraqitjes së kontesteve pronësore për ndalimin e pengim posedimit. Që pengim posedimi të kuptohet në aspekte të tjera praktike në këtë temë janë trajtuara disa raste nga praktika gjyqësore .